FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 125

Tiranë – E enjte, 12 shtator 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11267, datë 9.9.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	9149
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 604, datë 11.9.2019	Për ngritjen e Sekretariatit të Komitetit Koordinues të Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM-CC) dhe të Komitetit Drejtues Politiko-Ushtarak / Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore (PMSC/MPFSEE) në Shqipëri.....	9149
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 11.9.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike", Lushnjë.....	9150
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 609, datë 11.9.2019	Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e Operatorit të Tregut.....	9152
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 11.9.2019	Për shpalljen e liqenit të Fierzës si zonë bashkëmenaxhuese peshkimi...	9156
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 611, datë 11.9.2019	Për zgjerimin e sipërfaqes së "Parkut Kombëtar 'Mali i Tomorit'"	9157
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Elton Seranaj.....	9164

DEKRET
Nr. 11267, datë 9.9.2019

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Lavderim Ismet Saraçi
2. Edlira Argjend Harisi (Kacanja)
3. Anastasia Vasillaq Harisi
4. Eneida Nexhip Anner (Terolli)
5. Liam Tahir Osmani
6. Danilo Mitro Gorović (Vjeshta)
7. Arsen Mehdi Hoxha
8. Arben Dimitrov Popaj
9. Ertigen Shkëlqim Ramaliu
10. Marsela Shamet Dosti (Stroka)
11. Ariola Stavro Myftari (Labi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 604, datë 11.9.2019

PËR NGRITJEN E SEKRETARIATIT TË KOMITETIT KOORDINUES TË MINISTERIALIT TË MBROJTJES SË EVROPËS JUGLINDORE (SEDM-CC) DHE TË KOMITETIT DREJTUES POLITIKO-USHTARAK / FORCËS PAQERUAJTËSE SHUMËKOMBËSHE TË EVROPËS JUGLINDORE (PMSC/MPFSEE) NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të marrëveshjes dhe të protokollit shtesë "Për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Evropës Juglindore", ratifikuar me ligjin nr. 8544, datë 4.11.1999, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Sekretariatit të Komitetit Koordinues të Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM-CC) dhe të Komitetit Drejtues Politiko-Ushtarak / Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore (PMSC/MPFSEE) në Shqipëri, në varësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së SEDM-CC-së dhe të PMSC/MPFSEE-së.

2. Sekretariati i SEDM-CC-së dhe i PMSC/ MPFSEE-së të funksionojë deri më 1.7.2021.

3. Sekretariati i SEDM-CC-së dhe i PMSC / MPFSEE-së do të ketë kryetar zëvendësministrin e Mbrojtjes dhe do të përbëhet nga personel civil e ushtarak, si më poshtë vijon:

a) 3 (tre) specialistë - civilë;
b) oficeri i shtabit për operacionet - ushtarak;
c) nëpunësi i protokollit - ushtarak;
ç) përgjegjësi i administratës - ushtarak.

4. Personeli civil i Sekretariatit emërohet dhe lirohet nga detyra nga ministri i Mbrojtjes, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës, ndërsa personeli ushtarak emërohet dhe lirohet nga detyra nga ministri i Mbrojtjes, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ministria e Mbrojtjes të sigurojë mjediset dhe pajisjet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë e për funksionimin e Sekretariatit.

6. Paga e punonjësve civilë në pozicionet "Specialist" të jetë ajo e kategorisë IV-a, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë. Personeli ushtarak i Sekretariatit të trajtohet me pagë sipas gradës, në përputhje me nenin 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e ushtarakëve të Forcave të Armatosura.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 608, datë 11.9.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE", LUSHNJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike", Lushnjë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 16 503 358.20 (gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë njëzet) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 16 503 358.20 (gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë njëzet) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit, Bashkia Lushnjë.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, Bashkia Lushnjë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA ME VLERËSIMIN PARAPRAK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, LUSHNJË"

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Rrethi	Sip. e ndërtimit (m^2)	Sip. e truallit (m^2)	Çmimi i ndërtimit (l/m^2)	Çmimi i truallit (l/m^2)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	Xhevdet Korreshi	ZK. 8571	7/104/15	Lushnjë	___	283.3	___	9,709	___	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1 prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit "Truall".
2	Bashkëpronarët Lufta	ZK. 8571	7/104/16	Lushnjë	___	283.3	___	9,709	___	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit "Truall".
3	Bashkëpronarët Habili dhe Çela	ZK. 8571	7/104/17	Lushnjë	___	283.3	___	9,709	___	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1 prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit "Truall".
4	Hekuran Korreshi	ZK. 8571	7/104/18	Lushnjë	___	283.3	___	9,709	___	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1 prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit "Truall".
5	Hasan Korreshi	ZK. 8571	7/104/19	Lushnjë	___	283.3	___	9,709	___	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1 prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit "Truall".
6	Petrit Korreshi	ZK. 8571	7/104/20	Lushnjë	___	283.3	___	9,709	___	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1 prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit "Truall".
	VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT										**16,503,358.20**	

VENDIM
Nr. 609, datë 11.9.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË PJESËMARRËSVE NË KAPITALIN E OPERATORIT TË TREGUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/2, të nenit 57, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KRITERET PËR ZGJEDHJEN E SUBJEKTEVE JURIDIKE TË CILAT DO TË MARRIN PJESË NË KAPITALIN E OPERATORIT TË TREGUT

1. Ministri përgjegjës për energjinë autorizon fillimin e procedurës konkurruese të përzgjedhjes së subjekteve juridike që marrin pjesë në kapitalin aksionar të Operatorit të Tregut në Shqipëri (përveç "Operatorit të Sistemit të Transmetimit" sh.a., më tej referuar si OST sh.a.").

2. Ministri përgjegjës për energjinë dhe ministri që ushtron të drejtat e pronësisë mbi OST sh.a., ngrenë me urdhër të përbashkët Komisionin e Posaçëm, i cili përbëhet nga 5 (pesë anëtarë) dhe ka përbërje, si më poshtë vijon:

a) kryetarin nga ministria përgjegjëse për energjinë;

b) 1 (një) anëtar nga ministria përgjegjëse për energjinë;

c) 1 (një) anëtar nga ministria që ushtron të drejtat e pronësisë mbi OST sh.a.;

ç) 2 (dy) anëtarë nga OST sh.a.

3. Komisioni i Posaçëm ka këto kompetenca:

a) harton, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, dokumentet e procesit konkurrues, që specifikojnë mënyrën e zhvillimit të procesit konkurrues, për përfitimin e masave mbështetëse;

b) harton kritere të veçanta të aplikimit dhe të kualifikimit, bazuar në përcaktimet e pikës 15, të këtij kreu;

c) harton metodologjinë e vlerësimit, e cila është pjesë e dokumenteve të procesit konkurrues;

ç) vlerëson ofertat e ofertuesve, bazuar në kriteret e kualifikimit të ofertës;

d) harton raportin përfundimtar të vlerësimit dhe e paraqet për miratim pranë ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit që ushtron të drejtat e pronësisë mbi OST sh.a.;

dh) mund të angazhojë ekspertizë të veçantë, vendase ose të huaj, për të asistuar gjatë zhvillimit të procesit;

e) çdo funksion tjetër bazuar në parashikimet e këtij vendimi.

4. Procedura konkurruese e përzgjedhjes do të vijojë me publikimin nga Komisioni të njoftimit për shprehjen e interesit si dhe të afatit përfundimtar për shprehjen e tij, në të paktën:

a) një gazetë kombëtare;

b) Buletinin e Njoftimeve Zyrtare;

c) dy gazeta ndërkombëtare.

5. Kostot dhe shpenzimet për procedurat konkurruese, përfshirë botimin në gazeta kombëtare dhe ndërkombëtare, hartimin e dokumenteve standarde dhe asistencën e ekspertëve të jashtëm të specializuar (nëse do të jetë e nevojshme), do të përballohen nga pjesëmarrësit e përzgjedhur në përpjesëtim me aksionet e tyre. Në rast se nuk do të ketë asnjë pjesëmarrës të përzgjedhur, këto kosto do të mbulohen nga OST sh.a.

6. Komisioni vendos në dispozicion të pjesëmarrësve të interesuar dokumentet standarde për pjesëmarrjen në procedurën konkurruese me kërkesën e tyre, sipas afatit të përcaktuar në dokumentet standarde.

7. Komisioni cakton një afat për paraqitjen e propozimeve nga pjesëmarrësit, i cili në asnjë rast nuk mund të jetë më i shkurtër se 4 (katër) javë nga shpallja sipas pikës 4, të këtij kreu.

8. Dokumentet standarde të procesit konkurrues, ndër të tjera, përmbajnë:

a) formularin e njoftimit, përfshirë përshkrimin e projektit, kapitalin minimal, vlerën nominale të propozuar të aksioneve, përqindjen indikative të aksioneve të rezervuara për OST sh.a., afatin për të gjithë procesin, përfshirë periudhën e negociimit dhe afatin e nënshkrimit të projektstatutit dhe/ose projektmarrëveshjes së aksionarëve;

b) udhëzimet për pjesëmarrësit;

c) kriteret specifike dhe të përgjithshme për pjesëmarrjen për çdo kategori (për operatorë të tjerë të Sistemit të Transmetimit (TSO), për operatorët me eksperiencë ndërkombëtare (OEN), për pjesëmarrësit në tregut të energjisë (PTE) ose për institucionet financiare ndërkombëtare (IFN));

ç) formularin për deklarimin e konfliktit të interesit;

d) dispozitat e përgjithshme të projektstatutit të Operatorit të Tregut dhe/ose të projektmarrëveshjes së aksionarëve.

9. Në dokumentet strandarde të procesit konkurrues të përcaktohet detyrimi, si më poshtë:

a) pas themelimit të shoqërisë, çdo transferim i aksioneve nga një palë e tretë që kërkon të marrë pjesë në kapitalin aksionar të Operatorit të Tregut duhet të marrë pëlqimin paraprak nga OST sh.a.

OST sh.a., në çdo rast, do të marrë edhe mendimin e ministrisë përgjegjëse për energjinë, e cila do të verifikojë përmbushjen e kritereve të aksionarit të mundshëm, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe me interesin publik;

b) në rast zvogëlimi të përqindjeve të zotëruara, të shkaktuar si pasojë e hyrjes së ndonjë aksionari të ri të Operatorit të Tregut pas themelimit të tij, ky zvogëlim do të prekë në mënyrë të barabartë pjesët e zotëruara nga operatorët e sistemit të transmetimit, të cilët do të jenë aksionarë të Operatorit të Tregut.

10. TSO-të duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) të jenë një subjekt juridik i themeluar dhe i regjistruar në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian ose të Komunitetit të Energjisë;

b) të jenë të licencuar si një Operator i Sistemit të Transmetimit në shtetin ku janë të regjistruar;

c) në zonën e tregut ku veprojnë, nuk duhet të angazhohen në veprimtarinë e tregut të ditës në avancë ose të tregut brenda ditës (p.sh. ditë në avancë PX), të vetëm ose së bashku me operatorë të tjerë;

ç) të mos jenë në gjendje falimentimi apo likuidimi dhe të posedojnë të gjitha autorizimet dhe miratimet e nevojshme për të hyrë në procesin konkurrues të përzgjedhjes.

11. OEN-të duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a)të jenë subjekt juridik i themeluar dhe i regjistruar në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian ose të Komunitetit të Energjisë ose një vend që ka nënshkruar një marrëveshje ose një memorandum me qeverinë shqiptare për bashkëpunim në sektorin e energjisë dhe bashkëpunim në lidhje me TSO-të;

b) të kenë më shumë se 5 vjet eksperiencë në kryerjen e veprimtarisë së operimit/menaxhimit të tregut të shkëmbimit të energjisë (të tregut të ditës në avancë dhe të tregut brenda ditës) në shtetin e tij dhe/ose rajonet përkatëse të veprimtarisë, ku zbatohen rregulla tregu të ngjashme me modelin e tregut të energjisë në Shqipëri;

c) të zotërojnë dhe të përdorin plotësisht një platformë të tregut të ditës në avancë (DAM), të përshtatshme për kombinimin multirajonal (MRC – Multi Regions Coupling) të plotë, një platformë të përshtatshme për tregti ndërkufitare brenda ditës (XBID), si dhe një platformë të situacionimit dhe kompensimit (clearing), ose të ketë përdorimin e kësaj të fundit;

ç) të provojnë që rezultatet financiare të shoqërisë kanë qenë pozitive për 3 vitet e fundit;

d) të jenë anëtarë të plotë të kombinimit rajonal të çmimeve (PRC - Price Coupliong of Regions) dhe MRC, që të jenë në gjendje të ofrojnë konceptin evropian Serviced PX dhe të kenë akses në algoritmin Euphemia;

dh) të jenë operatorët e emëruar të tregut të energjisë elektrike në tregun e tij të brendshëm, si dhe të paktën në tregun e një juridiksionin tjetër, për të treguar pranim dhe miratim të gjerë rregullator;

e) të kenë eksperiencë të provuar në fillimin dhe funksionimin e plotë tregjeve të përshtatshme për operim MRC në Bashkimin Evropian në drejtim të sistemeve të IT, të procedurave të operimit dhe të rregullave të shkëmbimit;

ë) të mos jenë në gjendje falimentimi apo likuidimi dhe të posedojnë të gjitha autorizimet dhe miratimet e nevojshme për të hyrë në procesin konkurrues të përzgjedhjes.

12. PTE-të duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) duhet të jenë subjekt juridik i cili është themeluar dhe operon në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian ose të Komunitetit të Energjisë, ose në një vend që ka nënshkruar një marrëveshje ose një memorandum me qeverinë shqiptare për bashkëpunimin në sektorin e energjisë dhe bashkëpunim në lidhje me TSO-të. Në rast se marrin pjesë me shumë se një PTE, ato që janë themeluar në vendet e TSO-ve që janë aksionarë të Operatorit të Tregut do të kenë përparësi në vlerësim;

b) duhet të jenë të pajisur me licencën përkatëse për aktivitetin prodhimit, dhe/ose të tregtimit dhe/ose të furnizimit;

c) duhet të kenë jo më pak se 5 vjet si pjesëmarrës dhe të operojnë në tregun e energjisë elektrike në më shumë se një nga vendet e Bashkimit Evropian dhe/ose të Komunitetit të Energjisë, si shprehje e interesit dhe e eksperiencës në tregun e energjisë elektrike;

ç) të kenë një volum minimal vjetor të transaksioneve të energjisë elektrike mbi 100 000 MWh për 5 vitet e fundit;

d) të mos jenë në gjendje falimentimi apo likuidimi dhe të posedojnë të gjitha autorizimet dhe miratimet e nevojshme për të hyrë në procesin konkurrues të përzgjedhjes;

dh) në rast se ka pjesëmarrje kapitali në projekte/aktivitete të tjera të lidhura me sektorin e energjisë elektrike, duhet të japin shpjegime të plota dhe shteruese si dhe një skemë organizative në lidhje me pjesëmarrjen e tij në kapitalin e Operatorit të Tregut, që të jenë të mjaftueshme për të garantuar shmangien e çdo konflikti interesi.

13. IFN-të duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) të jenë një institucion financiar i cili është themeluar kryesisht nga më shumë se një vend (por edhe institucione të tjera ndërkombëtare ose organizata mund të jenë aksionare të tij) bazuar në një traktat ose konventë dhe për këtë arsye është subjekt i së drejtës ndërkombëtare. Në rast se marrin pjesë më shumë se një IFN, institucionet në të cilat Shqipëria është anëtare do të kenë përparësi në vlerësim;

b) të japin shpjegime të plota e shteruese, si dhe të propozojnë një skemë organizative të përshtatshme në lidhje me pjesëmarrjen e tij në kapitalin e Operatorit të Tregut, në rast se ka pjesëmarrje kapitali në projekte të tjera për prodhimin e energjisë, me qëllim shmangien e çdo konflikti interesi.

14. Kërkesat konkrete specifike, që duhet të plotësohen nga pjesëmarrësit dhe dokumentet që duhet të vihen në dispozicion, përcaktohen në dokumentet standarde. Ato mund të përbejnë aspekte të detajuara të kërkesave të përgjithshme të parashikuara me sipër, por duhet të përfshijnë kërkesat e përcaktuara në pikën 15, të këtij kreu.

15. Kërkesat specifike që duhet të përmbushin pjesëmarrësit përbëhen nga:

a) Kërkesat ligjore, të cilat përmbajnë informacione lidhur me aspektet ligjore të organizimit të pjesëmarrësve, si forma e shoqërisë, statuti dhe akti i themelimit, miratimet ose autorizimet e brendshme të shoqërisë në lidhje me pjesëmarrjen në procedurë, miratimet/licencat/autorizimet e autoriteteve publike apo enteve rregullatore, identitetin e përfaqësuesve ligjorë, statusi ligjor dhe deklarata të tjera siç kërkohet dhe specifikohet në dokumentet standarde;

b) Kërkesat teknike, të cilat përmbajnë informacion lidhur me veprimtarinë tregtare të pjesëmarrësit, eksperiencën, projektet e ngjashme, zotërimin e njohurive dhe të teknologjive, mjetet financiare, përshkrimin se si pjesëmarrësi do të kontribuojë në fillimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit të Operatorit të Tregut;

c) Kërkesat financiare, të cilat përmbajnë informacione mbi shumën e kapitalit që do të investohet, një fashë të përqindjes së propozuar për nënshkrimin e aksioneve dhe shumën e pjesëmarrjes në kapitalin e Operatorit të Tregut, burimin e kapitalit, stabilitetin financiar.

II. PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN

1. Propozimet e pjesëmarrësve në procedurën e konkurrimit duhet të dorëzohen brenda afatit të caktuar në dokumentet standarde të publikuara. Secili pjesëmarrës duhet të paraqesë vetëm një propozim. Konsorciume, bashkime shoqërish ose struktura të ngjashme me to nuk lejohen.

2. Përfaqësuesit e pjesëmarrësve në procedurën e konkurrimit mund të marrin pjesë në hapjen e propozimeve të paraqitura.

3. Komisioni cakton kohën, datën dhe vendin në të cilin do të bëhet vlerësimi i propozimeve.

4. Procedura e vlerësimit do të bazohet në një sistem vlerësimi me pikë, sipas metodologjisë së përcaktuar në dokumentet konkurruese dhe Komisioni do të shqyrtojë të gjitha dokumentet që përmban secili nga propozimet.

5. Për secilën kategori pjesëmarrësish, si: TSO, OEN, PTE ose IFN kryhet një procedurë e ndarë vlerësimi.

6. Komisioni ka të drejtë t'i kërkojë pjesëmarrësve informacione ose dokumente shtesë në mënyrë që të arrihet një vlerësim më i mirë në lidhje me përmbushjen e kërkesave. Dokumentet shtesë do të kërkohen vetëm për të qartësuar më mirë dokumentet e dhëna në ofertën e paraqitur. Në rast se kërkohen dokumente shtesë, këto duhet të sigurohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

7. Pas vlerësimit të propozimeve nga secili anëtar, Komisioni harton përmbledhjen e pikëve për çdo pjesëmarrës në secilën kategori dhe përgatit një renditje përfundimtare.

8. Në rast se më shumë se një pjesëmarrës ka të njëjtin numër pikësh, Komisioni shqyrton përsëri dokumentacionin që i përket këtyre pjesëmarrësve, me qëllim që të identifikojë kombinimin më të mirë të përmbushjes së kritereve të përgjithshme dhe të atyre specifike nga këta pjesëmarrës, duke marrë parasysh, gjithashtu, se si ky kombinim do të shërbente për qëllimin e themelimit të Operatorit të Tregut.

9. Pjesëmarrësi që ka rezultatin më të lartë do të jetë fituesi në kategorinë e dhënë.

10. Në bazë të renditjes së pikëve të marra, Komisioni mund të zgjedhë më shumë se një TSO (përveç OST sh.a.), OEN, PTE dhe IFN, për t'u kualifikuar si pjesëmarrës në strukturën e kapitalit, brenda përqindjes së aksioneve që janë rezervuar për atë kategori, sipas legjislacionit përkatës, duke pasur parasysh edhe përqindjen e propozuar nga ofertuesit e përzgjedhur në ofertën e tyre.

11. Komisioni përgatit një raport përmbledhës për ministrin përgjegjës për energjinë dhe ministrin që ushtron të drejtat e pronësisë mbi OST sh.a. Pas miratimit të raportit nga dy ministrat, Komisioni njofton fituesit për secilën kategori, sipas rastit. Raporti përmban:

a) objektin e procedurës së konkurrimit;

b) një përmbledhje të procedurës së ndjekur;

c) numrin e propozimeve të paraqitura dhe një përmbledhje të secilit propozim;

ç) kriteret e vlerësimit të propozimeve dhe vlerësimin sipas këtyre kritereve të çdo propozimi;

d) renditjen e pjesëmarrësve sipas vlerësimit nga Komisioni dhe pjesëmarrësit e përzgjedhur për secilën kategori.

12. Ministri përgjegjës për energjinë njofton OST sh.a. dhe pjesëmarrësit e përzgjedhur për të filluar negociatat për nënshkrimin e marrëveshjes së aksionarëve dhe të statutit të Operatorit të Tregut.

13. Ministria përgjegjëse për energjinë njofton, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, për arsyet e shkualifikimit, pjesëmarrësit të cilët nuk janë përzgjedhur. Kundër vendimit të ministrisë për shkualifikim, pjesëmarrësit kanë të drejtën e ankimit, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit të shkualifikimit. Numri i saktë i aksioneve që do të nënshkruhen ndërmjet aksionarëve të përzgjedhur të kategorisë së TSO-ve (përfshirë OST sh.a.) do të negociohet ndërmjet tyre, duke marrë në konsideratë përqindjen e aksioneve të propozuara nga secili TSO në procesin e përzgjedhjes. Në rast se aplikon vetëm një TSO (përveç OST sh.a.) dhe ky TSO i përzgjedhur nuk kërkon të nënshkruajë të gjithë pjesën e mbetur të kapitalit aksionar të rezervuar për kategorinë e TSO-ve të tjera, por vetëm një përqindje të caktuar të saj, si dhe pas identifikimit të përqindjes së aksioneve që do të nënshkruhet nga OST sh.a., pjesa tjetër e aksioneve të kategorisë së TSO-ve që ka mbetur e panënshkruar do të nënshkruhet nga OST sh.a

14. Brenda aksioneve të mbetura për IFI-të e mundshme, në rast se një IFI nuk nënshkruan të gjithë kapitalin aksionar në dispozicion, një IFI të dytë e cila plotëson kushtet, sipas renditjes, do të ftohet për të nënshkruar. Në rast se IFI-ja e dytë nuk pranon ose nuk ka ndonjë IFI tjetër të zgjedhur, mund të negociohet me IFI-në e parë përsëri. Në rast se asnjë IFI nuk nënshkruan të gjithë ose një pjesë të mbetur të kapitalit aksionar të disponueshëm për kategorinë e IFI-ve, atëherë OST sh.a., dhe aksionarët e tjerë të kategorisë së TSO-ve në rast se pranojnë, nënshkruajnë (dhe

ndajnë në mënyrë të barabartë mes tyre) pjesën e mbetur të aksioneve të kësaj kategorie.

15. Brenda aksioneve të mbetura për OEN-të, në rast se një OEN nuk nënshkruan të gjithë përqindjen e kapitalit aksionar në dispozicion të kësaj kategorie, atëherë pjesa e mbetur i ofrohet një OEN-je të dytë, e cila i plotëson kushtet, sipas renditjes. Në rast se asnjë OEN nuk nënshkruan të gjithë ose një pjesë të mbetur të kapitalit aksionar të disponueshëm për kategorinë e OEN-ve, atëherë OST sh.a., dhe aksionarët e tjerë të kategorisë së TSO-ve, në rast se pranojnë, nënshkruajnë (dhe ndajnë në mënyrë të barabartë mes tyre) pjesën e mbetur të aksioneve të kësaj kategorie.

16. Brenda aksioneve të mbetura për PTE-të, në rast se një PTE nuk nënshkruan të gjithë përqindjen e kapitalit aksionar në dispozicion të kësaj kategorie, atëherë pjesa e mbetur i ofrohet një PTE-je të dytë, e cila i plotëson kushtet, sipas renditjes. Në rast se asnjë PTE nuk nënshkruan të gjithë ose një pjesë të mbetur të kapitalit aksionar të disponueshëm për kategorinë e PTE-ve, atëherë OST sh.a., dhe aksionarët e tjerë të kategorisë së TSO-ve, në rast se pranojnë, nënshkruajnë (dhe ndajnë në mënyrë të barabartë mes tyre) pjesën e mbetur të aksioneve të kësaj kategorie.

17. Negociatat ndërmjet pjesëmarrësve të përzgjedhur dhe OST, sh.a.-së nuk do të ndikojnë në kushtet themelore të marrëveshjes së aksionarëve dhe të statutit, siç janë publikuar në dokumentet standarde. Ministria përgjegjëse për energjinë mund të vendosë të ndryshojë vlerën nominale të aksioneve nëse kjo kërkohet nga aksionarët negociues dhe është vendimtare në arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet tyre.

18. Marrëveshja e aksionarëve dhe statuti do të ndryshohen, për aq sa kërkohet, me qëllim që:

a) të pasqyrojë ndryshimet e kërkuara ose të negociuara pas procedurave të konkurrimit;

b) të plotësojë të gjitha boshllëqet;

c) të bëhet korrigjimi i gabimeve dhe i mangësive.

19. Në rast se negociatat nuk përfundohen me nënshkrimin e marrëveshjes së aksionarëve dhe statutit brenda një afati prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh, ministria përgjegjëse për energjinë mund të vendosë të ftojë për negociata pjesëmarrësit e tjerë që kanë marrë pjesë në proces në bazë të pikëve të vlerësimit të dhëna nga Komisioni. Në rast se nuk ka pjesëmarrës për një kategori të caktuar, ministria do të rihapë procedurat e përzgjedhjes dhe do të krijojë një Komision të ri, sipas parashikimeve të kreut I.

III. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ministria përgjegjëse për energjinë dhe ministria përgjegjëse për ushtrimin e të drejtave të pronësisë mbi OST sh.a. duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për emërimin e Komisionit, sipas kreut I, të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 610, datë 11.9.2019

PËR SHPALLJEN E LIQENIT TË FIERZËS SI ZONË BASHKËMENAXHUESE PESHKIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e liqenit të Fierzës, hapësirë ujore me interes për peshkimin, si zonë bashkëmenaxhuese peshkimi.

2. Organizata e menaxhimit të peshkimit, brenda 12 muajve, nga data e shpalljes së kësaj zone, përgatit planin e bashkëmenaxhimit për liqenin e Fierzës, i cili miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për peshkimin.

3. Veprimtaritë dhe investimet që do të kryhen në zonën bashkëmenaxhuese të liqenit të Fierzës duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe për zonat e mbrojtura si dhe të mbahet në konsideratë qëllimi parësor i prodhimit të energjisë elektrike. Kontrata për ushtrimin e

aktivitetit të peshkimit, që do të lidhet me Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit, dhe plani i bashkëmenaxhimit të peshkimit për këtë zonë do të marrin pëlqimin paraprak nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 611, datë 11.9.2019

PËR ZGJERIMIN E SIPËRFAQES SË "PARKUT KOMBËTAR 'MALI I TOMORIT'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 36, të ligjit nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zgjerimin e sipërfaqes së "Parkut kombëtar 'Mali i Tomorit'", të shpallur me vendimin nr. 472, datë 18.7.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen 'Park kombëtar' të ekosistemit natyror mali i Tomorit, me sipërfaqe të zgjeruar", me një sipërfaqe prej 1 383 (një mijë e treqind e tetëdhjetë e tre) ha, sipas hartës dhe kufijve të paraqitur në tabelën e koordinatave, përkatësisht në shtojcat 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Me zgjerimin sipas pikës 1, sipërfaqja e "Parkut Kombëtar 'Mali i Tomorit'" bëhet 26 106.2743 (njëzet e gjashtë mijë e njëqind e gjashtë pikë dy mijë e shtatëqind e dyzet e tre) ha.

3. Zona e zgjerimit të parkut përfshin zona bujqësore dhe pyjore, shkurre e kullota. Mbulesa e tokës brenda shtesës së sipërfaqes së "Parkut Kombëtar 'Mali i Tomorit'" jepet në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Sipas zonimit, zona shtesë bën pjesë në zonën e përdorimit tradicional (ZPT), ku zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes.

5. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me ministritë e tjera të linjës, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet kërkimore-shkencore, me përfaqësuesit e biznesit dhe të pronarëve privatë, organizatat e shoqërisë civile, brenda 1 viti, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, hartojnë planin shtesë të menaxhimit të sipërfaqes së zgjeruar, si pjesë e planit të menaxhimit të parkut kombëtar, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore.

6. Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura të Qarkut Berat kryen funksionet e administratës së "Parkut kombëtar 'Mali i Tomorit'".

7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, harta e përcaktuar në pikën 1, të vendimit nr.472, datë 18.7.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen 'Park kombëtar' të ekosistemit natyror mali i Tomorit, me sipërfaqe të zgjeruar ", zëvendësohet me hartën bashkëlidhur në shtojcën 1, të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe organet përkatëse të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela 1. Sipërfaqja e SHTESËS SË PARKUT e përshkruar sipas mbulesës

Mbulesa	Sipërfaqja (ha)
Zona bujqësore	203.8108
Pyje, shkurre dhe vegjetacion bimor	1179.1892
	1383

SHTOJCA 1
HARTA E SIPËRFAQES SË ZGJERUAR TË PARKUT KOMBËTAR "MALI I TOMORIT"



SHTOJCA 2
KOORDINATAT E SIPËRFAQES SË ZGJERUAR TË
PARKUT KOMBËTAR "MALI I TOMORIT"

PIKA	X	Y		PIKA	X	Y
1	426038.41	4496311.36		51	425959.61	4497078.07
2	426017.24	4496314.54		52	425950.62	4497110.34
3	425983.38	4496310.83		53	425943.21	4497120.4
4	425967.5	4496302.37		54	425937.92	4497130.98
5	425962.74	4496317.71		55	425938.98	4497140.51
6	425954.8	4496347.35		56	425941.09	4497150.56
7	425956.13	4496374.07		57	425942.15	4497157.44
8	425959.83	4496389.95		58	425939.51	4497164.85
9	425967.24	4496407.41		59	425933.69	4497174.37
10	425970.41	4496432.81		60	425931.04	4497189.19
11	425974.65	4496453.45		61	425931.38	4497197.81
12	425977.82	4496484.14		62	425935.59	4497206.58
13	425978.35	4496512.71		63	425942.89	4497217.5
14	425978.35	4496536.52		64	426030.54	4497233.23
15	425972.53	4496547.64		65	426171.03	4497303.48
16	425961.95	4496561.92		66	426279.6	4497383.31
17	425959.83	4496576.74		67	426398.17	4497373.07
18	425955.6	4496589.44		68	426444.73	4497415.42
19	425946.07	4496605.32		69	426491.71	4497407.9
20	425940.78	4496616.96		70	426518.02	4497360.93
21	425939.19	4496638.65		71	426550.77	4497346.09
22	425943.43	4496656.12		72	426659.74	4497377.3
23	425945.79	4496670.27		73	426736.47	4497372.47
24	425946.12	4496686.47		74	426763.55	4497309.27
25	425942.15	4496701.69		75	426778.96	4497273.62
26	425942.15	4496712.6		76	426803.5	4497218.05
27	425942.48	4496722.19		77	426820.01	4497194.81
28	425945.13	4496731.12		78	426842.75	4497164.66
29	425956.04	4496751.96		79	426876.61	4497119.7
30	425958.03	4496765.52		80	426890.89	4497099.6
31	425957.37	4496780.07		81	426857.56	4497053.58
32	425957.7	4496786.68		82	426814.45	4496945.68
33	425959.35	4496794.29		83	426812.13	4496913.91
34	425962.99	4496800.24		84	426810.44	4496891.1
35	425964.31	4496806.86		85	426807.68	4496841.37
36	425963.98	4496812.15		86	426868.35	4496759.48
37	425960.34	4496819.43		87	426892.47	4496726.69
38	425958.36	4496826.37		88	426947.34	4496712.08
39	425959.02	4496831.99		89	426991.84	4496699.57

40	425962.26	4496841		90	427049.85	4496705.09
41	425969.67	4496855.81		91	427095.27	4496710.29
42	425970.73	4496866.93		92	427144.52	4496715.58
43	425971.26	4496882.27		93	427317.22	4496634.65
44	425974.43	4496906.61		94	427431.64	4496525.12
45	425972.31	4496933.6		95	427524.05	4496448.99
46	425974.43	4496944.71		96	427625.08	4496400.85
47	425978.14	4496962.71		97	427643.8	4496365.94
48	425975.49	4496996.57		98	427668.13	4496306.17
49	425971.26	4497014.04		99	427697.62	4496181.49
50	425966.49	4497053.19		100	427725.25	4496143.25
101	427737.3	4496139.17		151	429161.26	4492091.01
102	427753.16	4496139.17		152	429152.66	4492081.75
103	427769.03	4496139.17		153	429142.74	4492058.6
104	427787.67	4496137.43		154	429135.47	4492032.14
105	427815.7	4496185.04		155	429120.91	4491999.07
106	427873.5	4496203.97		156	429112.98	4491996.42
107	427956.73	4496227.36		157	429104.38	4492018.25
108	428095.05	4496304.58		158	429096.22	4492044.93
109	428175.19	4496392.39		159	429080.34	4492071.39
110	428310.07	4496497.12		160	429056.53	4492099.83
111	428346.57	4496553.19		161	429011.55	4492150.76
112	428359.6	4496696.45		162	428967.24	4492208.97
113	428429.08	4496858.4		163	428918.29	4492279.75
114	428501.44	4496987.96		164	428892.49	4492330.02
115	428549.42	4497172.07		165	428875.95	4492347.22
116	428783.48	4497161.49		166	428872.65	4492360.45
117	428986.6	4497131.87		167	428872.51	4492392.99
118	429299.23	4496969.57		168	428872.51	4492416.01
119	429430.94	4496762.75		169	428866.16	4492432.68
120	429504.46	4496648.5		170	428851.08	4492460.46
121	429568.47	4496549.59		171	428816.16	4492496.18
122	429652.04	4496419.46		172	428806.63	4492517.61
123	429770	4496236.97		173	428803.46	4492563.65
124	429858.07	4496099.98		174	428807.43	4492579.52
125	429931.13	4495984.45		175	428818.54	4492595.4
126	430066.01	4495771.55		176	428820.13	4492612.06
127	430197.66	4495569.96		177	428812.19	4492623.97
128	430314.03	4495447.25		178	428805.05	4492633.5
129	430469.54	4495284.33		179	428793.93	4492650.16
130	430657.24	4495086.96		180	428777.26	4492659.69
131	430673.18	4495070.13		181	428759.01	4492671.6
132	430676.31	4495049.86		182	428751.86	4492685.09

133	430704.39	4494872.1		183	428720.91	4492705.73
134	430729.6	4494708.69		184	428708.21	4492709.7
135	430798.55	4494270.17		185	428693.92	4492709.7
136	430673.53	4493721.27		186	428678.84	4492707.31
137	430497.63	4493570.96		187	428663.76	4492706.52
138	430415.37	4493364.71		188	428653.44	4492712.08
139	430284.42	4493038.69		189	428640.74	4492723.19
140	430094.44	4492574.4		190	428620.1	4492740.65
141	429976.01	4492481.85		191	428602.64	4492762.08
142	429748.4	4492306.1		192	428588.35	4492769.23
143	429272.39	4492150.67		193	428572.48	4492769.23
144	429201.3	4492016.04		194	428563.74	4492773.2
145	429192.35	4492023.54		195	428542.31	4492795.42
146	429185.74	4492032.8		196	428530.19	4492816.57
147	429182.43	4492047.35		197	428518.55	4492835.09
148	429179.78	4492087.7		198	428496.32	4492858.37
149	429175.82	4492095.64		199	428483.09	4492888.53
150	429168.54	4492096.3		200	428473.57	4492908.64
201	428447.11	4492940.39		251	427906.03	4493630.56
202	428428.06	4492961.56		252	427886.98	4493634.53
203	428414.83	4492980.61		253	427870.31	4493640.08
204	428404.24	4493007.6		254	427857.61	4493651.2
205	428388.9	4493048.34		255	427846.5	4493664.69
206	428386.25	4493065.27		256	427842.53	4493686.12
207	428390.35	4493079.69		257	427843.33	4493705.96
208	428400.28	4493095.57		258	427852.06	4493725.81
209	428416.81	4493137.9		259	427874.28	4493774.23
210	428434.67	4493145.18		260	427880.63	4493793.28
211	428443.27	4493152.46		261	427879.05	4493803.6
212	428434.01	4493163.7		262	427873.49	4493808.36
213	428418.8	4493166.35		263	427870.31	4493809.15
214	428402.26	4493176.93		264	427852.85	4493813.12
215	428378.45	4493198.76		265	427826.66	4493820.79
216	428364.56	4493222.57		266	427808.4	4493831.91
217	428346.04	4493283.42		267	427798.88	4493833.49
218	428346.04	4493313.19		268	427786.18	4493824.76
219	428342.07	4493325.76		269	427770.3	4493816.03
220	428330.16	4493329.73		270	427755.22	4493814.44
221	428320.9	4493327.08		271	427739.35	4493815.24
222	428307.67	4493319.14		272	427719.5	4493827.14
223	428299.73	4493307.24		273	427676.64	4493857.31
224	428285.18	4493297.31		274	427665.53	4493878.74
225	428261.37	4493285.41		275	427631.4	4493923.98

226	428242.85	4493279.46		276	427617.9	4493941.44
227	428230.94	4493282.1		277	427578.21	4493970.81
228	428214.41	4493296.65		278	427535.35	4493993.83
229	428189.27	4493321.79		279	427521.86	4494005.74
230	428165.46	4493366.77		280	427500.43	4494018.44
231	428144.95	4493396.53		281	427488.52	4494031.14
232	428131.72	4493426.96		282	427478.2	4494053.36
233	428132.38	4493438.21		283	427456.24	4494107.34
234	428138.34	4493447.47		284	427439.31	4494146.5
235	428146.94	4493461.36		285	427419.2	4494177.19
236	428150.24	4493477.23		286	427355.7	4494192.01
237	428149.58	4493495.75		287	427321.83	4494203.65
238	428145.61	4493504.35		288	427298.55	4494230.11
239	428134.37	4493508.32		289	427281.62	4494267.15
240	428115.58	4493509.11		290	427283.73	4494284.08
241	428081.45	4493519.43		291	427287.97	4494297.84
242	428058.43	4493532.93		292	427295.37	4494310.54
243	428038.59	4493537.69		293	427295.37	4494330.65
244	428018.75	4493542.45		294	427293.26	4494348.64
245	427990.96	4493557.53		295	427280.56	4494353.93
246	427971.12	4493570.23		296	427242.46	4494369.81
247	427958.42	4493586.11		297	427227.64	4494386.74
248	427934.61	4493608.33		298	427221.29	4494403.67
249	427922.7	4493621.03		299	427222.35	4494417.43
250	427912.38	4493628.18		300	427226.58	4494434.36
301	427213.88	4494438.6		351	426578.62	4495601.96
302	427198.01	4494446.01		352	426570.68	4495619.16
303	427169.43	4494461.88		353	426569.36	4495631.07
304	427138.74	4494486.22		354	426572	4495651.57
305	427100.64	4494513.74		355	426572	4495666.12
306	427087.94	4494529.61		356	426569.36	4495682.66
307	427083.71	4494551.84		357	426569.36	4495701.84
308	427062.54	4494620.63		358	426570.68	4495713.75
309	427047.59	4494658.1		359	426573.99	4495724.99
310	427023.78	4494692.5		360	426577.95	4495759.39
311	426987.4	4494742.11		361	426572	4495778.57
312	426977.48	4494769.89		362	426564.06	4495793.78
313	426971.52	4494795.69		363	426554.14	4495806.35
314	426957.63	4494817.51		364	426547.53	4495820.24
315	426936.47	4494845.3		365	426545.54	4495836.78
316	426917.28	4494864.48		366	426544.88	4495861.92
317	426904.05	4494890.94		367	426530.33	4495896.97
318	426896.78	4494907.47		368	426523.05	4495926.08

319	426892.81	4494925.99		369	426514.12	4495958.09
320	426891.49	4494943.19		370	426507.77	4495985.08
321	426888.84	4494954.44		371	426496.66	4496006.11
322	426881.56	4494965.68		372	426487.14	4496020.8
323	426868.47	4494977.72		373	426482.37	4496033.1
324	426838.31	4494993.6		374	426478.41	4496050.17
325	426826.4	4495007.09		375	426463.72	4496077.55
326	426815.29	4495028.52		376	426448.24	4496100.57
327	426789.89	4495061.86		377	426444.27	4496112.48
328	426760.52	4495111.86		378	426441.5	4496126.76
329	426746.23	4495139.65		379	426425.22	4496147
330	426719.24	4495167.43		380	426395.85	4496171.21
331	426713.69	4495180.13		381	426357.5	4496194.95
332	426710.51	4495192.83		382	426334.74	4496214.53
333	426705.75	4495212.67		383	426319.93	4496228.81
334	426689.87	4495256.33		384	426313.05	4496239.4
335	426671.62	4495292.05		385	426297.7	4496248.39
336	426666.85	4495310.3		386	426287.65	4496257.92
337	426663.68	4495319.83		387	426282.36	4496266.91
338	426650.19	4495335.7		388	426273.89	4496276.97
339	426639.07	4495362.69		389	426252.72	4496292.84
340	426628.75	4495388.09		390	426216.74	4496304.48
341	426623.99	4495396.82		391	426211.26	4496305.15
342	426618.44	4495411.11		392	426196.76	4496311.37
343	426614.47	4495423.81		393	426191.46	4496312.95
344	426608.38	4495439.24		394	426181.41	4496317.98
345	426600.44	4495456.44		395	426174	4496320.36
346	426595.15	4495468.35		396	426166.06	4496321.68
347	426598.46	4495482.24		397	426157.6	4496322.21
348	426602.43	4495500.76		398	426143.05	4496325.12
349	426600.44	4495519.94		399	426126.11	4496330.15
350	426590.52	4495554.34		400	426102.83	4496339.41
401	426093.57	4496347.61				
402	426084.57	4496352.38				
403	426075.58	4496353.17				
404	426070.28	4496351.85				
405	426067.37	4496347.35				
406	426064.73	4496342.32				
407	426054.94	4496324.86				
408	426047.06	4496307.94				
409	426038.41	4496311.36				

KËRKESË

Shtetasi Shpëtim Seranaj kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të vëllait të tij shtetasit Elton Seranaj, më datë 21.4.1997.

KËRKUES
Shpëtim Seranaj

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë